



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	30-03-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Org /Unit	Nr. Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	1706/2022		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.120/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.120/2022 të datës 14.02.2022 të parashtruar nga ankuesja me adrese

komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit Komisioni i Pavarur për Minera dhe Minerale, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 30.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.100/2022 e datës 14.02.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. OBLIGHET Drejtori i Përgjithshëm në Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, që për pozitën Zyrtar Certifikues ti ndryshoj Akt emërimin nga koeficienti 8 në koeficientin 9 të bëjë përshkrimin e detyrave të punës konform nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe përshkimit standard.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.



## A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] e punësuar në pozitën “ Zyrtares Certifikuese” në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, me datë 14.01.2022 me emali i është drejtuar zyrës se personelit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale që ti bëhet harmonizimi i koeficientit në pozitën përkatëse që ka si dhe rregullimi i përshkimit të detyrave të punës konform vendimit të datës 27.11.2014 të Ministrisë së Administratës Publike, mirëpo ankuesja nuk ka marr përgjigje brenda afatit të paraparë ligjor.

Ankuesja me datë 14.02.2022 ka parashtrua ankesë tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin ankimore që ti bëhet harmonizimi i koeficientit si dhe rregullimi i përshkrimit të detyrave të punës komform pozitës .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 18.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Ndërsa me datën 25.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova:** Ankesën me numër te protokollit 702/2022 të datës 14.02.2022; emalin e datës 21.12.2021; Shpalljen e rekrutimit të brendshëm për pozitën Zyrtares Certifikues; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit te emërimit të datës 10.06.2019; Emalin e datës 14.01.2022; Emalin e datës 24.12.2021; Emalin e datës 21.12.2019; Shkresën me numër 6038 e datës 27.11.2014 te Ministrisë se Administratës Publike lidhur me vendosjen e koeficienteve sipas pozitive përkatës; Përshkrimin detyrave të punës për pozitën “Zyrtares Certifikues”; Emalin e datës 11.01.2022 ;Kërkesa për përgjigje ne ankesë e datës 18.02.2022 me numër te protokollit 876/2022; Përgjigjja në ankesë e datës 25.02.2022 me numër të protokollit 1006/2022; Lista e pagave për ankuesen për muajin dhjetor te vitit 2021 dhe janar te vitit 2022; Aprovimi i rekrutimit te pozitës Zyrtares Certifikues dhe Administrativ ne KPMM me numër Ref. 002/KPMM i datës 21.02.2019; Organorgami i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale; Shkresën me numër të protokollit 904 të datës 01.04.2019 lidhur me procedimin ne sistemin e pagave ne Komisionin e Pavarur për Media dhe Minerale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e bazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që ti bëhet harmonizimi i koeficientit për pozitën “Zyrtares Certifikuese”, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi si dhe ti bëhet rregullimi i përshkrimit të detyrave të punës në bazë të pozitës, që mbanë në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.



Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses lidhur me harmonizimin e koeficientit dhe rregullimin e pozitës "Zyrtare Certifikuese", kolegji konstaton se organi i punësimit është i obliguar që të veprojë në pajtim me *nenin 9, paragrafi 1 të Ligji nr. 03/l-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë*, ku përcaktohet *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës*, dhe ti bëjë ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit, me të cilin duhet të vendoset koeficientit nënte (9) dhe të veprojë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse ankuesja deri në parashtrimin e ankesës në Këshill këtë të drejtë e ka realizuar me koeficient tete (8), sipas akt emërimit të datës 10.06.2019 të lëshuar nga Komisioni për Miniera dhe Minerale.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar, së në bazë të shkresës me numër të protokollit 6038, të datës 27.11.2014, të lëshuar nga Drejtori i DASHC-së, i Ministrisë së Administratës Publike, me të cilin njoftim është konstatuar se për pozitën "Zyrtar Certifikues" të vendoset koeficienti nënte (9), mbi bazën e kësaj kolegji konstaton se organi i punësimit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, duhet të bëjë ndryshimin e aktit të emërimit të ankueses sepse MAP gjegjësisht DASHC e tash MPB gjegjësisht DMZP është organ rregullator i kësaj fushe prandaj institucionet janë të obliguara që të bëjnë zbatimin e konstatimeve të këtyre organeve.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se organi i punësimit është i obliguar që të veprojë në pajtim me *nenin 3, paragrafi 2 Ligji nr. 03/l-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë*, ku përcaktohet *2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë*, sepse në bazë të shkresës së Ministrisë së Administratës Publike, me nivelin e pozitës dhe përshkrimin e detyrave të punës, është konstatuar se për pozitat "Zyrtar Certifikues" të vendoset koeficienti nënte (9), dhe të bëhet trajtimi për të gjithë nëpunësit civil në mënyre të barabarta që mbajnë pozitën e lartë cekur.

Kolegji për shqyrtimin, dhe vendosjen e ankesave, sa i përket pretendimit ankimor të ankueses që t'i bëhet rregullimi i përshkrimit të detyrave të punës sipas pozitës, konstaton se përshkrimi i detyrave të punës për pozitën "Zyrtar Certifikues" është përshkrim standard i detyrave të punës dhe i njëjti është i paraparë edhe me *nenin 14 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë këtë e kanë konfirmuar edhe nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme sipas emalit të datës 24.12.2021, si rrjedhojë në bazë të shkresave të lëndës, në përshkrimin e detyrave të punës të datës 08.04.2019 të dërguar nga organi i punësimit në përgjigje në ankesë, ka edhe përshkrim lidhur me ofrimin e shërbimeve administrative për Drejtorin dhe Bordin e KPMM-së, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se tek përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar Certifikues duhet të parashihen vetëm përshkrimi i detyrave të punës për këtë pozitë, por jo edhe përshkrim tjetër jashtë kësaj pozite. Nëse institucioni ka mungesë të pozitave atëherë sipas vlerësimit të tyre mund të caktoj një detyre shtesë me vendim.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se organi i punësimit Komisioni për Miniera dhe Minerale, pas pranimit të Vendimit të KPSHCK - së është i obliguar që ta shfuqizojë akt emërimin e ankueses ku është i përcaktuar koeficienti tetë (8),




duke bërë ndryshimin dhe plotësimin e Akt Emërimit, me të cilin duhet ti vendoset Koeficientit nëntë (9), për ankuesen të veprjës në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi si dhe përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar Certifikues të bëhet konform nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe përshkimit standard të dërguar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**LËNDA ME NUMËR A.NR.120/2022**

Ilire Mehmeti-Shaqiri

  
Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

